

VENDIM
Nr. 250, datë 16.8.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB SUN ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1892/7 prot., datë 11.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘ALB SUN Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892 prot., datë 7.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 19.7.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB SUN Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkinë Fier.

- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në medien e shkruar (në datat 20.7.2023 dhe 21.7.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.7.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892/2 prot., datë 18.7.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. Në vijim të shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën nr. 1893/4 prot., datë 28.7.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 229/2023 dhe i evidentoi dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar nga ky aplikim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1893/5 prot., datë 28.7.2023, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB SUN Energy” sh.p.k.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1893/6, datë 3.8.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ALB SUN Energy” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në

30 vjet, por duke qenë se, nga sa deklaruar nga shoqëria, rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ALB Sun Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ALB SUN Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti